



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRIA  
AGJENCIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE UJORE

Nr. 523 prot.

Tiranë, më 08.05. 2020

**VENDIM**

Nr. 38, datë 08.05.2020

**PËR  
MIRATIMIN E PROTOKOLLIT PËR PUNËT NË ZYRË DHE  
TERREN PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT  
NGA COVID-19**

Në zbatim të pikës 2, të kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.221, datë 26.04.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”, si dhe Udhëzuesit “Për administratën/punët në zyrë dhe terren (COVID -19)”, të Institutit të Shëndetit Publik nr.496/11 prot., datë 29.04.2020,

**VENDOS:**

I. Miratimin e protokollit për punët në zyrë dhe terren për parandalimin e përhapjes së infeksionit nga Covid-19 si më poshtë:

1. Të sigurohen në mënyrë të vazhdueshme elementët e higjenës, duke përfshirë: sapunin e duarve, dezinfektant me bazë alkooli (të paktën 60% alkool), letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim për pastrimin e sipërfaqeve, si dhe koshat e mbyllur për hedhjen e mbeturinave.
2. Drejtorët e AMBU-së dhe ZABU-ve të organizojnë punën e stafit në mënyrë që të lejohet një kombinim i punës nga shtëpia, (orari mund

të jëtë i ndryshëm nga orari i zakonshëm i punës) duke mundësuar rritjen e distancës fizike nga një punonjës tek tjetri.

3. Drejtorët e AMBU-së dhe ZABU-së të organizojnë punën në ambientet e institucionit duke siguruar distance prej 2m për stafin prezent në zyrë.
4. Të aplikohet larja e duarve dhe/ose përdorimi i dezinfektantëve kur ato janë të ndotura ose pas heqjes së maskes dhe dorezave (mbështetur në Udhëzuesin e MSHMS mbi hapat dhe mënyrën e larjes së duarve).
5. Nëpunësit/punonjësit nuk duhet të përdorin mjetet e njëri-tjetrit dhe postet e ndërsjellta të punës.
6. Nëpunësit/punonjësit duhet të respektojnë praktikën e etiketës respiratore, kollitjes apo teshtitjes.
7. Nëpunësit/punonjësit të respektojnë masat e distancimit social dhe fizik, duke respektuar distancën 2m nga njëri-tjetri.
8. Punonjësit e ngarkuar për pastrimin e ambienteve:
  - a. Të kryejnë pastrimin e vazhdueshëm të sipërfaqeve dhe elementëve të tjerë të vendit të punës. Produktet dizinfektuese të kenë përqindjen e caktuar të alkoolit, metodën e aplikimit dhe kohën e kontaktit të saktë, si dhe përdorimi i tyre të bëhet duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale (Udhëzuesi i MSHMS për pastrimin e mjedisit në objektet (jo të kujdesit shëndetësor) e ekspozuar ndaj COVID-19);
  - b. Të kryejnë dezinfektimin e ambienteve, pajisjeve të zyrave përpara orarit zyrtar të hapjes së zyrave dhe para largimit nga zyra, si dhe të bëhet ajrosja e tyre, të paktën 3 herë në ditë;
  - c. Të kryejnë pastrimin e korridoreve çdo 2 orë;
  - d. Të kryejnë pastrimin dhe dezinfektimin e tualeteve çdo 30 minuta.
9. Nëse në institucion ka pasur ose ka punonjës të sëmurë me Covid-19 apo kanë patur kontakte me persona të sëmurë me Covid-19, duhet

të vetëkarantinohen duke njoftuar mjekun e familjes dhe drejtuesin e AMBU/ZABU;

10. Nëpunësit/punonjësit që kanë shenja klinike, të qëndrojnë në shtëpi, të vetëdeklarohen dhe të monitorojnë shenjat klinike dhe për çdo shqetësim duke njoftuar mjekun e familjes ose të telefonojnë 127.
11. Nëse në institucion ka rast të dyshuar me Covid-19 të lajmërohet urgjentisht NJVKSH-ja dhe mjeku përkatës i familjes;
12. Çdo nëpunës/punonjës që punon në ambiente zyre duhet të vendosë detyrimisht maskë mbrojtëse ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili e cila duhet të lahet në 60 gradë dhe hekuroset, si dhe shami letre për higjienën e hundëve.
13. Të minimizohet kontakti me qytetarët duke i zëvendësuar takimet fizike me komunikimin online apo dërgim informacioni në rrugë postare;
14. Protokollit dhe udhëzuesit mbi tërësinë e masave të minimizimit të transmetimit të Covid-19, duhet të vendoset në ambientet e AMBU-së dhe ZABU-ve në vende të dukshme.
15. Nëpunësit/punonjësit që do të autorizohen nga AMBU-ja ose ZABU-ja për kryerjen e monitorime/faturime në terren duhet të zbatojnë në mënyrë rigorozë masat e distancimit fizik.

II. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTORI PËR GJITSHËM**

**Gerta Lubonja**

